



NDIKIMI I PANDEMISË COVID-19 NË SHËNDETIN MENDOR DHE GJENDJEN SOCIALE TË TË RINJËVE/REJAVE NË KOSOVË GJATË VITIT 2022



empowering young people



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Partnerët dhe Donatorët

Ky botim/analizë është realizuar në kuadër të projektit “Promovimi i lëvizjes feministe përmes fuqizimit të grave dhe burrave të rinjë” - me mbështetje nga Rrjeti i Grave të Kosovës dhe i financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e YMCA MOVEMENT - YMCA LËVIZJE, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i Rrjeti i Grave të Kosovës, dhe i Bashkimit Evropian.



ymca ▽

Mars 2023

Përmbajtja

Hyrje.....	4
Gjetjet kryesore.....	5
Metodologjia dhe rezultatet.....	5
Ndikimi i Covid - 19.....	6
Punësimi dhe Edukimi.....	7
Aktivitetet.....	8
Abuzimi.....	8
Kufizimet.....	9
Rekomandimet.....	9

Hyrje

Organizata YMCA MOVEMENT është duke implementuar projektin “Promovimi i lëvizjes feministe përmes fuqizimit të grave dhe burrave të rinjë” në qytetin e Pejës.

Qëllimi i këtij projekti është përmirësimi i jetës së të rinjëve dhe të rejave duke u fokusuar në zhvillimin e shkathtësive jetësore dhe luftimin e dhunës me baza gjinore. Ky projekt mbështetet nga Rrjeti i Grave të Kosovës dhe financohet nga Bashkimi Evropian.

Qëllimi i këtij hulumtimi është të fitohet një pasqyrë e situatës së të rinjëve/rejave në Kosovë si dhe të kuptohet më mirë ndikimi i pandemisë Covid-19 tek ata/ato.

YMCA në Kosovë është organizatë e bazuar në vlera e cila ka për qëllim të inspirojë dhe të inkurajoj udhëheqjen e të rinjëve/rejave dhe të asistojë në zhvillimin e shëndetshëm të komuniteteve.

YMCA ka 11 lokacione ku përfshihen qendrat për të rinjë/reja dhe dy dyqane të bamirësisë në gjashtë komuna të ndryshme të Kosovës (Prishtina, Peja, Gjakova, Deçan, Junik, Rahovec). Gjatë gjithë vitit organizata arrin të përfshijë më shumë se 3000 të rinj nga i gjithë vendi, qoftë përmes programeve në qendrat e YMCA, programeve në shkolla dhe në kampe, projekteve sezonale, ditëve ndërkombëtare të vetëdijësimit apo duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve dhe gjenerimit të të ardhurave vjetore.

Për më shumë informacione rreth organizatës vizitoni web faqen tonë:

<https://www.ymcacosovo.com>

- Sfida kryesore me të cilën të rinjtë dhe të rejat në Kosovë janë përballur në vitin 2022 është Shëndeti Mendor.
- Komunitet e Kosovës nuk kanë mjaftueshëm programe dhe qendra të cilat shërbejnë në përmirësimin e mirëqenies psikologjike të të rinjëve/rejave.
- Niveli i papunësisë në Kosovë, është shtysë që të rinjtë dhe të rejat të shohin perspektivën e punësimit jashtë Kosovës
- Pandemia Covid-19 dhe periudha e izolimit kanë pasur ndikim negativ në mirëqenien psikologjike të të rinjëve/rejave.
- Mbështetja dhe prioritetizimi i edukimit jo-formal është i rëndësishëm për përgatitjen për jetë dhe punë profesionale për të rinjtë/rejave
- Përmes aktivizimit qytetar mundësohet përfshirja e të rinjëve në proceset e vendimmarrjes në qeverisjen lokale dhe qendrore.
- Dhuna ndërpersonale në mes të rinjëve dhe të rejave është mjaft e shprehur në Kosovë


Metodologjia dhe Rezultatet

Mbledhja e të dhënave për nxjerrjen e rezultateve të mëposhtme është bërë përmes një pyetësi me pyetje të mbyllura. Të drejtë për të marrë pjesë në këtë hulumtim kanë pasur të rinjë dhe të reja nga moshë 14 deri në 19 vjeç.

Pjesë e këtij hulumtimi kanë qenë gjithsej 191 të rinjë dhe të reja, 35.1% e të cilëve kanë qenë të moshës 19 vjeçe, 82.2% janë identifikuar si vajza/gra dhe 70.7% pjesëmarrës kanë qenë nga zona urbane. Të anketuarit kanë qenë nga Prishtina, Peja, Gjakova, Ferizaji, Mitrovica, Deçani, Vushtrria, Lipjani, Klina, Drenasi, Gjiçani, Istogu, Suhareka, Novobërda, Kamenica, Rahoveci, Kaçaniku, Vitia, Podujeva, Obiliqi. Rreth 52.4% e pjesëmarrësve kanë të përfunduar shkollën fillore.


Ndikimi i Covid - 19

- “Në deklaratën “Periudha e izolimit ka ndikuar negativisht në gjendjen time emocionale” nga pjesëmarrësit/et janë marrë këto përgjigjie: 34.0% kanë qenë “Pajtohem”, 31.4% kanë qenë “Plotësisht Pajtohem”, 17.8% kanë qenë “Neutral”, 12.6% kanë qenë “Nuk Pajtohem”, dhe 4.2% kanë qenë “Assesi nuk Pajtohem”.
- Rreth 60.2% e pjesëmarrësve/eve janë pajtuar me deklaratën se Covid-19 ka ndikuar negativisht në shëndetin e tyre mendor.
- 29.3% e pjesëmarrësve/eve kanë raportuar Shëndetin Mendor si sfidën më të madhe nga fillimi i vitit 2022 deri në ditët e sotme. 19.9% e tyre kanë raportuar Papunësinë dhe 7.3% kanë raportuar Shëndetin Fizik
- Në deklaratën “Ndërprerja e mësimit në formë fizike në periudha të ndryshme kohore ka ndikuar negativisht tek unë në përgatitje arsimore” kanë qenë këto përgjigjie nga pjesëmarrësit/et: 38.7% kanë qenë “Plotësisht Pajtohem”, 37.7% kanë qenë “Pajtohem”, 16.2% kanë qenë “Neutral”, 6.3% kanë qenë “Nuk Pajtohem”, 1% kanë qenë “Assesi nuk Pajtohem”. Shikoni grafiken më poshtë.



Punësimi dhe Edukimi

- Në deklaratën "Sipas mendimit tim të rinjët/rejat në Republikën e Kosovës kanë mundësi punësimi pas përfundimit të shkollës së mesme apo Universitetit". Përgjigjet e pjesëmarrësve/eve ishin këto: 29.8% kanë qenë "Nuk pajtohem", 27.2% kanë qenë "Neutral", 19.9% kanë qenë "Pajtohem", 14.7% kanë qenë "Assesi nuk Pajtohem", dhe 8.4% kanë qenë "Plotësisht Pajtohem".
- Në deklaratën "Edukimi joformal ndikon që ne të përgatitemi për jetën dhe punën profesionale": 40.3% e pjesëmarrësve/eve kanë deklaruar se Pajtohen, 32.5% janë pajtuar plotësisht, 21.5% kanë qenë "Neutral", 5.8% kanë qenë "Nuk Pajtohem".
- Në deklaratën "Në komunën time nuk ka programe të edukimit jo-formal në të cilat unë mund të marrë pjesë" janë marrë këto përgjigje nga pjesëmarrësit/et: 29.3% kanë qenë "Neutral", 27.7% kanë qenë "Pajtohem", 19.9% kanë qenë "Nuk Pajtohem", 18.3% kanë qenë "Plotësisht Pajtohem", dhe 4.7% kanë qenë "Assesi nuk Pajtohem".
- 92.6% e pjesëmarrësve/eve janë pajtuar me deklaratën se niveli i papunësisë në Republikën e Kosovës ndikon që të rinjtë/rejat të shohin perspektivë jashtë



Aktivitetet

- Në deklaratën “Në qytetin tim nuk ka mjaftueshëm aktivitete/programe për Shëndetin Mendor” nga pjesëmarrësit/et janë marrë këto përgjigjie: 47.1% kanë qenë “Pajtohem Plotësisht”, 37.7% kanë qenë “Pajtohem”, 12.0% kanë qenë “Neutral”, 2.1% kanë qenë “Nuk Pajtohem”, dhe 1.0% kanë qenë “Assesi nuk Pajtohem”.
- Rreth 80.6% e pjesëmarrësve/eve janë pajtuar me deklaratën “Nuk ka mjaftueshëm programe ose aktivitete ku njerëzit relaksohen ose të largojnë stresin”
- Për deklaratën “Nuk jam i angazhuar në asnjë aktivitet vullnetar” të anketuarit/at kanë dhënë këto përgjigje: 28.8% kanë qenë "Nuk Pajtohem", 23.6% kanë qenë "Assesi nuk Pajtohem", 20.9% kanë qenë "Pajtohem", 15.2% kanë qenë "Neutral", 11.5% "Plotësisht Pajtohem".

Abuzimi

- Në deklaratën “Në vendin ku unë jetoj abuzimi në mes bashkëmoshatarëve është prezent” janë marrë këto përgjigjie nga pjesëmarrësit/et: 42.4% kanë qenë “Pajtohem”, 31.4% kanë qenë “Plotësisht Pajtohem”, 19.9% kanë qenë “Neutral”, 3.7% kanë qenë “Nuk Pajtohem”, 2.6% kanë qenë “Assesi nuk Pajtohem”.
- Ndërkaq, në deklaratën “Unë nuk kam marrë pjesë në programe/aktivitete të cilat flasin për abuzimin verbal apo fizik, por do të merrja pjesë nëse do të kishte programe/aktivitete të tilla” janë marrë këto përgjigjie nga pjesëmarrësit/et: 37.2% kanë qenë “Pajtohem”, 30.4% kanë qenë “Plotësisht Pajtohem”, 16.2% kanë qenë “Neutral”, 13.1% kanë qenë “Nuk Pajtohem”, 3.1% kanë qenë “Assesi nuk Pajtohem”.

Kufizimet

Një limitim potencial i këtij studimi mund të konsiderohet numri i mostrës. Duke marrë parasysh se rezultatet tregojnë gjendjen e të rinjëve/rejave në të gjithë Kosovën, numri i pjesëmarrësve/eve (191) mund të mos jetë i mjaftueshëm për të përgjithësuar gjetjet e studimit. Pos kësaj, mostra ka përfshirje më të madhe të vajzave/grave (82.2%), që mund të ndikoj në interpretimin e të gjeturave në studim.

Megjithatë, ky hulumtim paraqet një bazë të mirë mbi ndikimin e arsimit, papunësisë, dhe shëndetit mendor tek të rinjtë/rejat duke ndihmuar në krijimin e strategjive për përmirësimin e gjendjes sociale të tyre.

Rekomandimet

- Sugjerohet që komunat e Kosovës të ofrojnë programe jashtëshkollore dhe të organizojnë aktivitete të cilat ndihmojnë për ruajtjen e mirëqenies psikologjike tek të rinjtë dhe të rejat.
- Ministria e Arsimit duhet të angazhojë profesionist të Shëndetit Mendor në shkolla në përputhje me numrin e nxënësve/eve që kanë.
- Komunat duhet të mbështesin kampanjat, aktivitetet dhe trajnimet të cilat kanë për qëllim ngritjen e vetëdijes mbi rëndësinë e Shëndetit Mendor dhe zvogëlimin e dhunës në komunitet.
- Rekomandohet që qeveria dhe sindikatat e punëtorëve të krijojnë strategji të reja për angazhimin dhe punësimin e të rinjëve dhe të rejave në Kosovë.
- Sugjerojmë që institucionet qeveritare të nxjerrin metoda dhe strategji efikase për mësim në rast të pamundësisë për mësim të rregullt.
- Qeveria së bashku me komunat përkatëse rekomandohet që të investojë në rritjen e sigurisë në ambientet shkollore.



Copyright © 2023 All Rights Reserved.

YMCA™ & Young Men's Christian Association™ are registered trademarks of the World Alliance of YMCA's within the Republic of Kosovo territory. The YMCA Movement in Kosovo is the only entity permitted to use the YMCA™ & Young Men's Christian Association™ trademarks.